



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MUNDËSI BASHKËPUNIMI ME FONDACIONIN GJERMAN HUMBOLDT

Fondacioni Gjerman Alexandër von Humboldt ofron mundësinë e bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor nëpërmjet programeve të ndryshme. Ky fondacion ka një traditë të njohur mbi promovimin e bashkëpunimit akademik ndërmjet shkencëtarëve dhe studiuesve nga e gjithë bota në Gjermani.

Fondacioni Alexandër von Humboldt mbështetet financiarisht nga Ministria e Jashtme gjermane, Ministria Federale e Arsimit dhe Shkencës, Ministria Federale e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit, Ministria Federale e Mjedisit si dhe organizata partnere brenda dhe jashtë vendit.

Bursat për punë kërkimore shkencore u mundësojnë post-doktorantëve të kualifikimit të lartë dhe me eksperiencë që së bashku me kolegët gjermane të zhvillojnë punë kërkimore, duke krijuar në këtë mënyrë edhe marrëdhënie afatgjata bashkëpunimi.

Përfitimi i bursës realizohet:

- Shkencëtari i huaj për zgjedh vetë studiuesin pritës gjerman të një qendre shkencore gjermane dhe i propozon atij një projekt kërkimor shkencor.
- Kriteri qendror për akordimin e bursës është niveli shkencor i studiuesit të huaj.
- Nuk ka kuota kufizuese për disiplinat e ndryshme shkencore apo për vendet e origjinës.
- Nuk ka periudha të caktuara aplikimi ato mund të bëhen në çdo kohë.
- Gjuha gjermane nuk është kusht.
-

Programet kryesore të fondacionit janë:

1. Programi për post-doktoratë të huaj;

- Promovimi para jo më shumë se 4 vitesh;
- Kohëzgjatja e bursës 6-24 muaj;
- Zgjedhja individuale e partnerit akademik në Gjermani ;
- Bursa mujore 2.650 euro plus mbështetje për familjen, shpenzimet e udhëtimit, pagesën për kurs gjuhe.

2. Programi për shkencëtarë të huaj me eksperiencë;

- Promovimi para jo më shumë se 12 vitesh ;
- Kohëzgjatja e bursës 6-18 muaj, e ndashme në tre pjesë ;
- Zgjedhja individuale e partnerit akademik në Gjermani;
- Bursa mujore 3.150 euro plus mbështetje për familjen, shpenzimet e udhëtimit, pagesën për kurs gjuhe.

Përveç këtyre programeve bazë ka për secilin prej tyre edhe një version programi bursash për shkencëtarë nga vendet në zhvillim (të ashtuquajturat bursa "Georg Forster"), të cilat akordohen nëse vlerësohet që projekti i propozuar ka rëndësi nga pikëpamja e transferimit të dijes dhe teknologjisë në ato vende.

Për një informacion më të detajuar të interesuarit mund ti referohen adresës si më poshtë:

<http://www.humboldt-foundation.de>

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE